



11-02-2010

Prishtinë / Pristina

Nr./Br. 236-2010



Prishtinë/Prishtina, rr./ul. Agim Ramadani tel. +381 (0) 38 551 679; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 106.1, 106.3 dhe 106.4 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 9.6, 9.7 dhe 26 të Ligjit nr. 03/L-072 të për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës si dhe vendimin e KQZ-së të datës 22.12.2009 për përsëritjen e zgjedhjeve të Raundit të II-të për Kryetar të Komunave në Lipjan dhe Prizren, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 11.02.2010 nxjerrë këtë:

## VENDIM

### Për Certifikimin e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve të Raundit të II-të për Kryetar të Komunave në Lipjan dhe Prizren

- I. Pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotime dhe në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve si dhe kur të gjitha vërejtjet e dala që u përkasin votimit dhe numërimit janë vendosur nga Komisionit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP) dhe nga Gjykata Kushtetuese, **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve Certifikon Rezultatet Përfundimtare të Zgjedhjeve të përsëritura të Raundit të II-të për Kryetar të Komunave në Lipjan dhe Prizren të mbajtura me 31 janar 2010 si në vijim:**

#### Lipjan:

**Shukri Buja** nga SP "Partia Demokratike e Kosovës-PDK" ka fituar 14.336 vota ose 53,66% të votave;

**Imri Ahmeti** nga SP "Lidhja Demokratike e Kosovës-LDK" ka fituar 12.380 vota ose 46,34% të votave

#### Prizren:

**Ramadan Muja** nga SP "Partia Demokratike e Kosovës-PDK" ka fituar 30.720 vota ose 53,34% të votave;

**Hanefi Muharremi** nga SP "Lidhja Demokratike e Kosovës-LDK" ka fituar 26.874 vota ose 46,66% të votave

- II. Në pajtim me rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve nga pika I e këtij vendimi Kryetar i Komunës së Lipjanit shpallet kandidati i PDK-së Z. Shukri Buja, ndërsa Kryetar i Komunës së Prizrenit shpallet kandidati i PDK-së Z. Ramadan Muja.
- III. Rezultatet e Zgjedhjeve si në pikën I i janë bashkangjitur këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij. Poashtu këto rezultate janë përfundimtare dhe detyruese.
- IV. Obligohet Sekretariati i KQZ-së që t'i publikojë në formë tabelare rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve në pajtim me këtë vendim.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me 11.02.2010

Nesrin Lushta

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve